



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
MINISTRI

Nr. 19107 prot.

Data: 6, 10, 2023

VENDIM

Nr. 73, Datë 6, 10, 2023

PËR

VLERËSIMIN NË KUADËR TË HEQJES SË AKREDITIMIT ME KUSHT PËR OFRUESIN PUBLIK TË AFP-SË SHKOLLËN E MESME PROFESIONALE KAMËZ

Bazuar në pikën 2, të nenit 25, të ligjit nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, dhe urdhrin nr. 128, datë 06.07.2021, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, “Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional”,

VENDOSI:

- Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz, i ka plotësuar kushtet e vendosura në Vendimin nr. 5 datë 17.02.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, **Akreditim me kusht**, me afat vlefshmërie deri më 16.08.2023,
- Bazuar në Raportin e Monitorimit të Posaçëm dhe Urdhrin të miratimit të tij, i jepet vlerësimi përfundimtar pozitiv **akreditim i plotë** dhe heqja e kushteve të akreditimit sipas vendimit nr. 5, datë 17.02.2023, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për kualifikimet profesionale si më poshtë:
 - Kualifikimi Profesional “Shërbime Social Shëndetësore” Niveli II në KSHK O - II - 17
 - Kualifikimi Profesional “Shërbime kujdesi për të moshuar” Niveli III në KSHK O1 - III - 20
 - Kualifikimi Profesional “Shërbime kujdesi për fëmijë” Niveli III në KSHK O2 - III - 20
 - Kualifikimi Profesional “Shërbime Social Shëndetësore” Niveli IV në KSHK O - IV - 16
- Afati përfundimtar i **akreditimit të plotë** është 4 vite, duke filluar nga data e firmosjes së këtij vendimi.

4. Bazuar në pikën 1; shkronja a) e nenit 18, nr.128 datë 6.7.2021, të Urdhrit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë “ Për miratimin e Rregullores për Standardet, Kriteret dhe Procedurat e Akreditimit të Ofruesve të Arsimit dhe Formimit Profesional” Ofruesi publik i AFP-së Shkolla e Mesme Profesionale Kamëz, do t’i nënshtrohet vlerësimit të jashtëm çdo 4 vjet periodikisht, në kuadër të procesit të akreditimit institucional.

5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve për zbatimin e këtij vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit të plotë, brenda një muaji nga data e marrjes së këtij vendimi, si dhe monitorimin e vazhdueshëm, për të garantuar qëndrueshmërinë e përmirësimeve të reflektuara në kuadër të plotësisimit të kriterëve dhe veçanërisht ato që lidhen me zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të akreditimit.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR

Ervin METE

